



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË
“DARAN” SHPK

THEMELIMI
NENI 1
ORTAKET THEMELUES

1.1 Sot më datë 09.08.2021 themelohet shoqëria “Daran” SHPK nga Ortakët:

Z. Besmir Koçiu, shtetas shqiptar, lindur me 15.06.1987, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.036069324 dhe Nr. Personal I 70615005 K, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znj. Dafina Dodoveci, shtetas shqiptar, lindur me 28.04.1989, banues ne Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr.034680015 dhe Nr. Personal I 95428001 D, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë krijojnë shoqërinë Si vijon.

EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2
EMERTIMI

2.1 Emërtimi i shoqërisë është "DARAN" SHPK (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 3
FORMA LIGJORE

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4
BAZA LIGJORE

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statutin,

Adresa: Përballë restorant freskut rruga “Sotir Caci” Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore në fuqi.

4.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008. "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

4.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do të zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 5 PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA

5.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, Shqipëri.

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

NENI 6 SELIA

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia Administrative nr.12, Përballë restorant Freskut rruga "Sotir Caci", Pallati "Zaimaj sh.p.k", Dyqani 11, Tiranë.

6.2 Shoqëria mund të hapë dege, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

NENI 7 EMBLEMA. VULA

7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



NENI 8 OBJEKTI

8.1 Qendra multidisiplinore e kurseve plotësuese, konsulencës dhe ndërmjetësimit për punësim “Daran” gjithashtu dhe shitje blerje makinash riparime në servis, ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- 1- Kurse plotësuese për arsimin parauniversitar, universitar dhe pasuniversitar, ndërmjetësuese punësimi në tregun e punës, konsulentë edukimi, biznesi, trajnime për grupe të veçanta për mësuesit, punonjësit e mjekësisë.
1. Kryerjen e veprimtarisë plotësuese arsimore për të gjithë grup moshat 5-12 vjeç, 13-17 vjeç. Pas përfundimit të mësimit në shkollë fëmijët do të marrin mësim plotësues për përvetësimin e njohurive të marra në lëndët shkencore dhe shoqërore pra përfshihen detyrat e shtëpisë dhe mësim ekstra që nxënësit të përgatiten për të avanacuara në lëndë të ndryshme;
2. Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese për fëmijët me vështirësi në të nxënë dhe këshillim psikologjik për këtë kategori;
3. Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese për gjuhët e huaja për grup-moshat 5-18 vjeç dhe ofrimin e kurseve për mësimin e gjuhëve të huaja, si Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht dhe llojeve të tjera sipas kërkesave të tregut në nivelin fillestar, mesatar dhe mbi mesatar;
4. Kurse të formimit edukativ dhe kulturor sipas kërkesave të komunitetit;
5. Kurse përgatitore për pjesëmarrje në olimpiada kombëtare dhe ndërkombëtare për të gjitha lëndët shkencore dhe shoqërore;
6. Kurse përgatitore të avancuara për mbrojtjen e testeve kombëtare dhe ndërkombëtare për gjuhët e huaja Anglisht, Italisht, Frëngjisht, Gjermanisht, (TOEFL IBT®, SAT 1& SAT 2, IELTS GMAT, CELI, DELE, ESOL, etj.);
7. Kurse për mësimin e kompjuterit dhe përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike;
8. Ndërmjetësim në tregun e punës;
9. Konsulencë financiare për bizneset;
10. Ndërmjetësim në fushën e arsimit të lartë privat në Shqipëri, Evropë, Kanada, Amerikë;
11. Hartim, menaxhim teknik dhe financiar projektsh me financim kombëtar dhe të huaj;
12. Organizimin e aktiviteteve të ndryshme social-ekonomike-sportive-edukative për llogari të personave të tretë qofshin këto OJF apo forma të tjera organizimi;
13. Ofrimin e trajnimeve dhe konsulencës për studime të avancuara pasuniversitare masteri, doktorature, ndërmjetësimin në fushën e arsimit dhe shkollimit jashtë vendit;

Adresa: Përballë restorant freskut rruga “Sotir Caci” Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



14. Ofrimin e Trajnimeve të target grupeve të veçanta si mësuesve, punonjësve të mjekësisë, të shërbimeve të sigurisë për arritjen e krediteve të nevojshme sipas profesioneve në kuadrin e edukimit të vazhdueshëm;
15. Ofrimin e trajnimeve për studentet për programet Financa 5, Alfa web, kontabilitet, legjislacioni tatimor, programe specifike të kompanive;
16. Shërbime të tjera si juridike, ekonomike dhe financës, organizim eventesh të ndryshme si konferenca, workshop/seminare;
17. Studime, kërkime dhe botime në fushën e shkencave ekonomike, shkencave natyrore, të mësuesisë dhe fusha të lidhura me to; Botime shkollore, joshkollore, botime te ndryshme;
18. Studime të ndryshme në fushën shkencore teknologjike dhe didaktike;
19. Konsulenca ekonomike, financiare dhe profesionale për personat private, kompanitë private, entet shtetërore dhe organizatat joqeveritare, vendase dhe të huaja;
20. Ofrimin e trajnimeve për prindërit;
21. Aplikime në e- Albania për leje/ licenca në fushën e mjedisit;
22. Konsulencë mjedisore, ekspertizë lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim Mjedisor, Ndikim në mjedis etj.);
23. Plotësim kërkesash dhe aplikime për leje Mjedisit Tipi A dhe B;
24. Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorit;
25. Riparim dhe mirëmbajtje karrocierie;
26. Riparim dhe mirëmbajtje e gomave;
27. Blerje dhe shitje e mjeteve me motor dhe rimorkiove;
28. Mbledhje depozitim shkatërrim i mjeteve rrugore ose të pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura;
29. Blerje shitje online të produkteve të ndryshme;
30. Shitje dhe blerje të materialeve kancelarie, libra shkollore dhe joshkollore;
31. Ofrimin e trajnimeve për marketingun digjital;

8.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

NENI 9 KAPITALI THEMELTAR

9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë.

9.2 Kapitali themeltar përbehet nga 2 (dy) kuota.

9.3 Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët në masën si më poshtë:

Z. Besmir Koçiu, zotëron 1 (një) kuote me vlere nominale 70,000 (shtatëdhjetë mijë) Lekë që përben 70 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



Znj. Dafina Dodoveci, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 30,000 (tridhjetë mijë) Lekë që përbën 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

9.5 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10 TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.

10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 11 VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendose, por pa u kufizuar në to, vendimet si më poshtë:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratorët, përfshi raportet financiare;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri të tjera;
- ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
- emërimin e eksperteve kontabël të autorizuar, në qofte se është e nevojshme;
- rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- ristrukturimin dhe prishjen e shoqërisë;

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



- emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit të administratorit- (eve);
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- dhe çdo veprim tjetër të parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 12 ADMINISTRIMI

12.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një ose me shume administratore që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakeve. Në rast se Shoqëria do të administrohet nga me shume se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkatës të Asamblesë së Ortakeve.

12.2 Administratori i parë i shoqërisë është:

Z. Besmir Koçiu, shtetas shqiptar, lindur me 15.06.1987, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr.036069324 dhe Nr. Personal I 70615005 K, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

12.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet personalisht ose me përfaqësim;
- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
- në lidhjen e kontratave për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta;
- në lidhjen e kontratave me punëmarrësit, kryerjen e procedurave për largimin nga marrëdhënia e punës;
- përfaqëson shoqërinë përpara çdo institucioni shtetëror qendror apo vendor, si edhe pranë bankave të nivelit të dyte dhe Bankës së Shqipërisë si dhe kryen çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- ndërmerre çdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



12.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vite me të drejte ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

12.5 Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupi personash të gjitha apo një pjesë të kompetencave të tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet që ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anulojë këtë transferim kompetencash.

NENI 13 VITI FINANCIAR

13.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

13.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar i shoqërisë do të filloje nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 14 BILANCI. KONTABILITETI

14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri në fund të muajit Mars të çdo viti pasardhës.

14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operatione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 15 TE ARDHURAT, DIVIDENDI

15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;

e-mail: darancompany2021@gmail.com;

tel: 0693490470;



15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve.

15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 16 LIKUIDIMI

16.1 Likuidimi i Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(eve) bëhet në përputhje me ligjin nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjetër të zbatueshëm.

NENI 17 MOSMARRËVESHJET

17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do të nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 18 KLAUZOLE MBYLLESE

16.1 Ky Statut hartohet ne 3 (tre) ekzemplare me fuqi te njëjtë ligjore.

ORTAKET

Z. Besmir Koçiu

Znj. Dafina Dodoveci

Adresa: Përballë restorant freskut rruga "Sotir Caci" Njësia Administrative nr 12, Tiranë;
e-mail: darancompany2021@gmail.com;
tel: 0693490470;